



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 10561/7798/3447 Regjistri Themeltar
Datë 22.06.2015 regjistrimi

Nr. 2111(2190) Vendimi
Datë 17.05.2017

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga:

GJYQTAR : Kastriot SELITA
GJYQTARE : Altina NASUFI
GJYQTARE: Bernina KONDI

-asistuar nga sekretare gjyqësore [REDACTED], në Tiranë në datë 17.05.2017 mori në shqyrtim në dhomë këshilli, çështjen administrative me palë ndërgjyqëse:

PALË KËRKUESE:

Shoqëria tregtare "[REDACTED]" sh.p.k., me NIPT
[REDACTED] me seli Rruga nacionale Fushë Krujë.
[REDACTED] me përfaqësues ligjor.
[REDACTED]

PERSON I TRETË:

Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

OBJEKTI I PADISË:

Rivendosje në afat për kundërshtimin nëpërmjet kërkesë padisë në Gjykatën e Tiranës të aktit administrativ, datë 24.09.2014 me nr. prot. 802/1 nxjerrë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

SHKAKU LIGJOR I PADISË:

Neni 151 dhe 152 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 231, akti, datë 25.02.2015 ka vendosur:

- Shpalljen e moskompetencës lëndore dhe tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes civile me nr. 231 Akti, dt. Regj. 12.02.2015.
- Dërgimin e kësaj çështjeje për gjykim në Gjykatën kompetente e cila është Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Tiranë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Lartë brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga dita e shpalljes për kërkuuesin.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 2908 (80-2015-1482) datë 28.05.2015 ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në ligj dhe në prova.
- Shpenzimet gjyqësore të provuara si të parapaguara, janë në ngarkim të palës kërkuese.

- Ndaj këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit Administrativ, sipas afateve ligjore.

Kundër këtij vendimi në datë 02.06.2015 ka paraqitur ankim të veçantë pala kërkuese duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit nr. 2908, shpallur më datë 28.05.2015 dhe pranimin e kërkesës për të drejtën e rivendosjes në afat:

Vendimi i gjykatës është një vendimi me zbatim të keq dhe mosrespektim të ligjit e provave të paraqitura, për shkaqet si më poshtë vijon:

- Gjykata konkludon gabim që kërkesa nuk mbështetet në prova me shkresë, pasi provat e paraqitura (siç janë: deklaratat e administratorëve dhe parashtrimi i rrethanave subjektive dhe kronologjike); këto prova nuk mjaftojnë siç kërkon legjislacioni për rivendosjen në afat dhe Komisioneri për Diskriminimin në konkluzionet e tij përfundimtare, të cilat s'kanë asnjë argument dhe bazë ligjore në kundërshtim të kërkesës, pra konkluzione të cilat nuk mbështesin dhe vetë vendimin e gjykatës, pasi konkluzionet i referohen faktit të gjuhës ndaj qytetarëve të huaj dhe nuk i referohet bazës ligjore përkatës të rivendosjes në afat.
- Faktet që janë paraqitur nga pala kërkuese janë të qarta; shtetasi italian [redacted] ish Administrator i Shoqërisë [redacted] është vënë në dijeni të këtij akti administrativ kur ai kishte marrë formë të prerë dhe i kishte humbur afati ligjor për të ushtruar të drejtën e kundërshtimit ndaj këtij vendimi nëpërmjet kërkesë padisë. Administratori i mëparshëm [redacted] duke qenë një shtetas i huaj, pra nuk kupton dhe flet aspak gjuhën shqip, plus një keqinterpretim të avokatit të mëparshëm të këtij vendimi, nuk ka perceptuar përmbajtjen e saktë të këtij vendimi. Nuk ka perceptuar dhe rrjedhimisht nuk ka qenë në dijeni të një vendimi të padrejtë dhe kundër shoqërisë [redacted] sh.p.k., i cili ka konstatuar gabimisht një diskriminim. Gjithashtu edhe shtetasi [redacted] Administrator i Shoqërisë [redacted] është vënë në dijeni të këtij akti administrativ kur ai kishte marrë formë të prerë dhe i kishte humbur afati ligjor për të ushtruar të drejtën e tij të kundërshtimit ndaj këtij vendimi nëpërmjet kërkesë padisë. Shtetasi [redacted] nuk ka pasur asnjëherë dijeni për zhvillimin e këtij akti dhe për këtë fakt ka emëruar avokat të ri për të ankimuar këtë Akt Administrativ. Gjithashtu dhe administratorja tjetër, edhe kjo shtetase e huaj spanjolle [redacted] ka qenë në të njëjtat rrethana të kolegeve të saj si më lart. Të gjithë personat e lartpërmendur, duke qenë që janë rezidentë jashtë Shqipërisë dhe vijnë vetëm për mbylljen e bilancit domethënë 3 mujorin e parë të çdo viti, janë vënë në dijeni të këtij vendimi vetëm me datë 03.02.2015 dhe urgjent më datë 09.02.2015 është paraqitur kërkesa për rivendosje në afat për ankimimin e aktit administrativ datë 24.09.2014 me nr. prot. 802/1 nxjerrë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pra provohet fakti që administratorët e Shoqërisë [redacted] sh.p.k., nuk kanë pasur dijeni për aktin administrativ.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar ka vendosur pranimin e ankimit.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

në dhomë këshillimi, pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarës Altina Nasufi, shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi.

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes:

I Pala kërkuese ka qenë palë pjesëmarrëse në procedimin administrativ të zhvilluar prej palës së tretë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri) të inicuar prej ankesës së shtetases [REDACTED]

1.1 Midis palës kërkuese dhe shtetases [REDACTED] ka lindur një mosmarrëveshje juridike për shkak të përfundimi të marrëdhënies së punës, pasi pala kërkuese ka qenë punëdhënësi i saj përgjatë periudhës kohore të përcaktuar, viti 2014.

1.2 Ankuesja, [REDACTED] sh-punonjëse pranë palës kërkuese shoqërisë "[REDACTED]" shpk lidhur me këtë mosmarrëveshje ka paraqitur ankesë paraqitur me nr. 46 regjistri, datë 19.05.2014 pranë personit të tretë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Bazuar në këtë ankesë, kjo e fundit ka zhvilluar komunikim shkresor me palët, konkretisht me anë të shkresës me nr. 491/1, datë 27.05.2014, ku i njoftohet ankesa dhe i kërkohet informacion lidhur me çështjen, për të cilën pretendohet diskriminimi nga ish-punonjësja, [REDACTED]

1.3 Më datë 12.06.2014 kërkuesi, shoqëria "[REDACTED]" i ka kthyer përgjigje Komisionerit nëpërmjet shkresës së firmosur nga vetë Administratori [REDACTED] me objekt "Përgjigje njoftimit të kërkesë për informacion të drejtuar "Protec shoes sh.p.k" nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me nr. prot. 496/1, datë 27.05.2014" duke kontestuar pretendimet e [REDACTED] dhur me diskriminimin i cili është ofendues dhe paradoksal shkak i ngritur prej saj se është diskriminuar për faktin se ka qenë shtatzënë pasi kërkuesi ka zbatuar gjithë detyrimet lidhur me të drejtat e saj.

1.4 Është sqaruar gjithashtu se ajo ka filluar punë pranë kësaj shoqërie në vitin 2012 në pozicionin financiere, sipas një kontrate me afat njëvjeçar (me afat të caktuar) dhe më postë i është dërguar në datë 02.05.2013 mosrinovimi i kontratës, në bazë të legjislacionit në fuqi (Kodit të Punës nenit 147).".

1.5 Nëpërmjet shkresës nr. 496/4, datë 24.06.2014 me lëndë: "Dërgohet Urdhri nr. 97, datë 24.06.2014 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi "Për kryerjen e inspektimit pranë shoqërisë [REDACTED] me qëllim kryerjen e verifikimeve të nevojshme mhi ankesën e znj. [REDACTED] Komisioneri i ka komunikuar shtetasit [REDACTED] Administrator i Shoqërisë [REDACTED]", zhvillimin e inspektimit administrativ të caktuar me datë 26.06.2014. Administratori i shoqërisë "[REDACTED]", i cila ka caktuar një përfaqësues të [REDACTED] sh.p.k, konkretisht ekonomistin [REDACTED] për zhvillimin e inspektimit (është mbajtur procesverbali përkatës i inspektimit administrativ datë 26.06.2014).

1.6 Në përfundim të procedimit administrativ të ankesës me nr. 46 regjistri, datë 19.05.2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet Vendimit nr. 146, datë 24.09.2014 ka vendosur:

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjinisë dhe paaftësisë së përkohshme në punë, të znj. [REDACTED] nga ana e shoqërisë "[REDACTED]" sh.p.k:

2. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme nga ana e administratorit të Shoqërisë [REDACTED] sh.p.k. për njohjen e të gjithë punonjësve të kësaj shoqërie, me ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi". si dhe një kopje të ligjit të afishohet në ambientet e brendshme të Shoqërisë;

3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Shoqëria "██████████" sh.p.k të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi;

4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë".

1.7 Ky vendim i është komunikuar palëve, konkretisht ankueses ██████████ dhe z. ██████████ Administratori i ██████████ sh.p.k, me shkresën përcjellëse nr. 802/1, datë 24.09.2014 të Komisionerit.

1.8 Në përgjigje të shkresës 802/1, datë 24.09.2014 të Komisionerit, nëpërmjet së cilës, komunikohet vendimi nr. 146, datë 24.09.2014 pala kërkuese "██████████" sh.p.k ka kthyer përgjigje me shkresën nr. prot. 7, datë 14.10.2014, lidhur me marrjen e masave për zbatimin e pikës 2 të vendimit nr. 146, datë 24.09.2014 (janë njohur punonjësit me ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 duke e lexuar me zë të lartë dhe ka rregjistruar këtë proces me video kamera dhe ka afishuar dukshëm atë në ambientet e shoqërisë).

1.9 Me vërtetimin e datës 04.05.2015 e nr. 81/598 prot lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë vërtetohet se është në shqyrtim çështja me nr. 81 akti, datë 31.10.2014 me palë paditës ██████████ dhe palë e paditur shoqëria ██████████ shpk me objekt: Konstatimi i diskriminimit, detyrim dëmshpërblimi.

2. Kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesën objekt gjykimi duke pretenduar se ka humbur afatin ligjor për të kundërshtuar gjyqësisht aktin administrativ të nxjerrë prej personit të tretë. Komisioneri, përkatësisht vendimi me nr. 146, datë 24.09.2014, pasi shtetasi ██████████ ish Administrator i Shoqërisë "██████████" është vënë në dijeni të këtij akti administrativ kur ai kishte marrë formë të prerë dhe i kishte humbur afati ligjor për të ushtruar të drejtën e kundërshtimit ndaj këtij vendimi nëpërmjet kërkesëpadisë. Administratori i mëparshëm z. ██████████ duke qenë një shtetas i huaj, nuk kupton dhe flet aspak gjuhën shqip, plus një keqinterpretimi të avokatit të mëparshëm të këtij vendimi, ██████████ nuk ka perceptuar përmbajtjen e saktë të këtij vendimi. Nuk ka perceptuar dhe rrjedhimisht nuk ka qenë në dijeni të një vendimi të padrejtë dhe kundër shoqërisë ██████████ sh.p.k., i cili ka konstatuar gabimisht një diskriminim.

2.1 Gjithashtu edhe shtetasi ██████████ Administrator i Shoqërisë "██████████" është vënë në dijeni të këtij akti administrativ kur ai kishte marrë formë të prerë dhe i kishte humbur afati ligjor për të ushtruar të drejtën e tij të kundërshtimit ndaj këtij vendimi nëpërmjet kërkesëpadisë. Shtetasi ██████████ nuk ka pasur asnjëherë dijeni për zhvillimin e këtij akti dhe për këtë fakt ka emëruar avokat të ri për të ankimuar këtë akt administrativ.

2.2 Gjithashtu, edhe administratorja tjetër, edhe kjo shtetase e huaj spanjolle ██████████ ka qenë në të njëjtat rrethana të kolegëve të saj si më lart.

2.3 Të gjithë personat më lart përmendur, duke qenë që janë rezidentë jashtë Shqipërisë dhe vijnë vetëm për mbylljen e bilancit domethënë 3 mujorin e parë të çdo viti, janë vënë në dijeni të këtij vendimi vetëm me datë 03.02.2015 dhe me datë 09.02.2015 është paraqitur kërkesa për rivendosje në afat për ankimimin e aktit administrativ datë 24.09.2014 me nr. prot. 802/1 nxjerrë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pra, provohet fakti që administratorët e Shoqërisë "██████████" sh.p.k., nuk kanë pasur dijeni për aktin administrativ.

3. Personi i tretë, Komisioneri për Diskriminim ka prapësuar se në bazë të akteve shkresore konkretisht shkresa me nr. prot 7, datë 14.10.2014, e palës paditëse lidhur me marrjen e masave për zbatimin e pikës 2 të vendimit nr. 146, datë 24.09.2014) provohet se ka marrë rregullisht dijeni për aktin administrativ.

4. Avokatura e shtetit, Zyra Vendore Tiranë ka deleguar te drejtën e përfaqësimit dhe mbrojtjes organit të administratës publike.

II. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

5. Gjykata ka rrëzuar kërkesën për rivendosje në afat me këtë arsyetim ligjor:

5.1 Vendimi nr. 146, datë 24.09.2014 të personit të tretë, Komisioneri nuk është gjë tjetër. veçse akti administrativ i nxjerrë nga ky organ, në të cilin është pasqyruar vullneti i këtij të fundit për ankesën e shtetases [REDAKTUAR] për konstatimin e faktit të diskriminimit në përfundimin e marrëdhënies së punës. Ky vendim për nga forma dhe përmbajtja përfaqëson një akt administrativ me karakter individual. i cili ka sjelle pasojë juridike për kërkuesin.

5.2 Referuar ligjit të posaçëm me nr. 49/2012 pala kërkuese ka patur të drejtë të kundërshtojë vendimin nr. 146, datë 24.09.2014 të Komisionerit sipas parashikimeve të nenit 18 dhe nenit 72 të ligjit me nr. 49/2012. Rezulton se kërkuesja nuk e ka paraqitur padinë brenda afatit të parashikuar shprehimisht në ligj, duke humbur në këtë mënyrë afatin ligjor për paraqitjen e saj. Kjo është dhe arsyeja pse ajo ka paraqitur kërkesën për rivendosje në afat të kësaj të drejte mbështetur në nenet 151 dhe 152 të K.Pr.Civile. Afatet e vendosura nga ligji janë të zakonshme, përveç rastit kur ligji i parashikon shprehimisht të prera. Kur flasim për afate të prera kemi parasysh që këto të fundit: (i) parashikohen shprehimisht nga ligji; (ii) mosrespektimi i tyre shkakton dekadencën e të drejtës apo të tagrit për kryerjen e veprimeve procedurale; (iii) ato nuk mund të zgjaten, shkurtohen, shtyhen, as dhe me pëlqimin e palëve; (iv) si dhe janë të pandryshueshme, me përjashtim të rastit kur pala vërteton se nuk ka dijeni të zhvillimit të procesit gjyqësor për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve. Në analizë të dispozitës së mësipërme Gjykata arrin në konkluzionin që jo për çdo humbje të së drejtës, (për mosrespektim të afatit ligjor), subjekti mund të ketë të drejtë të rivendoset në afat. Rivendosja në afat sipas nenit 151 të K.Pr.Civile mund të bëhet vetëm për shkaqe të arsyeshme dhe vetëm në ato raste kur ligji nuk e ka parashikuar këtë afat si prekluziv. Në rast se ky afat nuk është parashikuar shprehimisht nga ligji si prekluziv, atëherë pala që ka humbur këtë të fundit për shkaqe të arsyeshme është e detyruar që të bëjë kërkesë para gjykatës për rivendosje në afat. Vlerësimi i shkaqeve të arsyeshme është në çmim të gjykatës dhe është më se e domosdoshme që pikërisht shprehjes "shkaqe të arsyeshme" t'i bëhet një interpretim i saktë me qëllim që shkaqet e humbjes së afatit të jenë bindëse dhe të tilla që të kenë ndikuar drejtpërsëdrejti në humbjen e tij.

5.3 Gjykata në referim të provave të administruara në dosjen gjyqësore si dhe të parashtrimeve të bëra në seancë gjyqësore nga kërkuesja arrin në konkluzionin se kërkimi i kërkueses në këtë gjykim është i pabazuar si në ligjin material, ashtu dhe në atë procedural dhe si i tillë ai nuk duhet pranuar. Siç u parashtrua dhe më lart në këtë vendim, kërkuesja kishte të drejtë të paraqiste ankimin e saj padinë kundër vendimit nr. 146, datë 24.09.2014 të Komisionerit brenda një afatit ligjor prej komunikimit të tij, në gjykim u provua që kërkuesja ka marrë rregullisht dijeni për aktin dhe ka njoftuar me shkrim edhe Komisionerin për marrjen e masave në zbatim të aktit. Kërkuesja pretendon se nuk ka paraqitur padi në Gjykatë dhe ka humbur afatin e depozitimit të saj për arsye se janë ndërruar administratorët e shoqërisë dhe se administratori i autorizuar në

kohën e kryerjes së veprimit administrativ duke qenë shtetas i huaj nuk ka kuptuar saktë përmbajtjen e aktit të Komisionerit, pasi nuk është njohës i gjuhës shqipe dhe i është përkthyer jo saktë.

5.4 Gjykata çmon se provat e sjella nga kërkuesja në seancë gjyqësore si dhe pretendimet e saj (të përmendura më lart në këtë vendim), janë të pambështetura në ligjin procedural të kohës dhe nuk përbëjnë shkak për rivendosje në afat të së drejtës së humbur. Provat e paraqitura prej saj si ekstraktet e QKR-së që janë ndryshuar administratorët e shoqërisë, nuk justifikojnë kërkuesen në humbjen e afatit ligjor për paraqitjen e padisë dhe në të njëjtën kohë nuk përbëjnë shkak ligjor për të pranuar kërkesën e saj. Nga ana e kërkueses nuk u soll asnjë provë në seancë gjyqësore, për të justifikuar faktin dhe për të treguar një shkak të arsyeshëm, se përse ajo nuk e ushtroi të drejtën e saj brenda afatit të caktuar në ligj, nga dita e marrjes dijeni të vendimit të Komisionerit. Gjithashtu nuk u paraqit asnjë provë për të krijuar bindjen e arsyeshme përpara gjykatës, se kërkuesja kishte pamundësi për të kërkuar të drejtën e saj të pretenduar të shkelur. Afati i përcaktuar në nenin 18 të ligjit me nr. 49/2012 është një afat i caktuar me ligj, i cili konsiderohet i prerë. Ky afat procedural duhet respektuar, në të kundërt e drejta që kërkuesja ka, shuhet. Kërkuesja për shkak të mjeteve (financiare ekonomike) që zotëron si shoqëri tregtare, prezumohet të ketë mundësinë objektive të punësojë jurist(ë) të kualifikuar që duhet të njihte shumë mirë rregullat procedurale në lidhje me afatet e ankimit si zhvillohet një proces gjyqësor, pasojat që vijnë nga mos ushtrimi në kohë i të drejtave të parashikuara në ligj si dhe deri ku shkojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve. Gjykata vëren se procedura administrative për konstatimin e faktit të e diskriminimit në marrëdhëniet e punës dhe vijueshmëria e procesit prej personit të tretë Komisioneri, është një procedurë e parashikuar prej legjislationit të Republikës së Shqipërisë tërësisht i përputhshëm me direktivat e BE-së, qytetar i të cilit është edhe administratori i kërkueses. Për sa më sipër, Gjykata përfundimisht vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesja shoqëria tregtare është e pabazuar në prova dhe në ligj dhe për këtë arsye duhet të rrëzohet.

III. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

6. Gjykata kryesisht konstatoi se çështja përbën lëndë juridiksioni gjyqësor dhe se ajo ka kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykimit të saj bazuar në nenet 7 dhe 10 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe duke iu referuar për zbatim Vendimit Njehsues Administrativ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 3, datë 06.12.2013.

7. Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, sikurse ka vlerësuar drejt edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë. Gjykata Administrative e Apelit konstaton se ankimi i veçantë është paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr. 49/2012 Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, i ndryshuar, brenda afatit ligjor, në respektim të formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga neni 454 i Kodit të Procedurës Civile, para gjykatës kompetente, nga subjekti i legjitimuar në të drejtën e ankimit, jashtë kushteve ndaluese të nenit 45 të ligjit nr.49/2012(vendimet e paankimueshme).

8. Në funksion të analizës së shkaqeve të ngritura në ankim, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor të zhvilluar në respektim të dispozitave procedural, të zbatuara drejt në raport me faktet objekt gjykimi dhe provat e marra në shqyrtim gjyqësor dhe për këto arsye duhet lënë në fuqi.

9. Kodi i Procedurës Civile në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, ka efekt subsidiar përsa në nenin 1 të tij është parashikuar se dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për atë që ky ligj nuk parashikon ndryshe. Meqënëse në ligjin nr. 49/2012 nuk ka ndonjë parashikim të shprehur dhe ndalues lidhur me rivendosjen në afat të së drejtës së padisë, referenca ligjore në shqyrtimin e këtij aspekti procedural do të jenë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

9.1 E drejta për t'u rivendosur në afate proceduale civile është një e drejtë e njohur sipas nenit 151 të Kodit të Procedurës Civile ku parashikohet shprehimisht se: "Kur palët ose prokurori që ka ngritur padi, për shkaqe të arsyeshme kanë humbur afatin ligjor ose atë të caktuar nga gjykata, mund të kërkojnë prej saj rivendosjen në afat, përveç kur afatet kanë karakter prekluziv." Ndërsa në nenin 152 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet procedura për gjykimin e kërkesës sipas të drejtës të parashikuar në nenin 151 të Kodit të Procedurës Civile.

10. Nga faktet e parashtruara para gjykatës ka rezultuar se pala kërkuese ka marrë dijeni lidhur me vendimin e Komisionerit pasi në përgjigje të shkresës 802/1, datë 24.09.2014 të Komisionerit, nëpërmjet së cilës, komunikohet vendimi nr. 146, datë 24.09.2014 pala kërkuese "██████████" sh.p.k ka kthyer përgjigje me shkresën nr. prot. 7, datë 14.10.2014, lidhur me marrjen e masave për zbatimin e pikës 2 të vendimit nr. 146, datë 24.09.2014 (janë njohur punonjësit me ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 duke e lexuar me zë të lartë dhe ka rregjistruar këtë proces me video kamera dhe ka afishuar dukshëm atë në ambientet e shoqërisë). Pala kërkuese ka pretenduar në gjykimin në shkallë të parë dhe në ankim se ka humbur afatin e paraqitjes së padisë për shkakun se: administratori i mëparshëm z. ██████████, duke qenë një shtetas i huaj, nuk kupton dhe flet aspak gjuhën shqip; një keqinterpretim i avokatit të mëparshëm të këtij vendimi; ██████████ nuk ka perceptuar përmbajtjen e saktë të këtij vendimi; nuk ka perceptuar dhe rrjedhimisht nuk ka qenë në dijeni të një vendimi të padrejtë dhe kundër shoqërisë ██████████ sh.p.k., i cili ka konstatuar gabimisht një diskriminim; edhe shtetasi ██████████ Administrator i Shoqërisë ██████████ është vënë në dijeni të këtij akti administrativ kur ai kishte marrë formë të prerë dhe i kishte humbur afati ligjor për të ushtruar të drejtën e tij të kundërshtimit ndaj këtij vendimi nëpërmjet kërkesës padisë; shtetasi ██████████ nuk ka pasur asnjëherë dijeni për zhvillimin e këtij akti dhe për këtë fakt ka emëruar avokat të ri për të ankimuar këtë akt administrativ; gjithashtu, edhe administratorja tjetër, edhe kjo shtetase e huaj Spanjolle ██████████, ka qenë në të njëjtat rrethana të kolegëve të saj si më lart; të gjithë personat më lart përmendur, duke qenë që janë rezidentë jashtë Shqipërisë dhe vijnë vetëm për mbylljen e bilancit domethënë 3 mujorin e parë të çdo viti, janë vënë në dijeni të këtij vendimi vetëm me datë 03.02.2015 dhe me datë 09.02.2015 është paraqitur kërkesa për rivendosje në afat për ankimimin e aktit administrativ datë 24.09.2014 me nr. prot. 802/1 nxjerrë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Të gjitha këto shkaqe të renditura nga pala kërkuese, në fakt kanë ngelur vetëm në nivelin e pretendimeve, të pabazuara në prova dhe me të drejtë nga gjykata e shkallës së parë janë vlerësuar si jo të arsyeshme për të rivendosur në afat të drejtën e padisë së humbur. Rezulton se pala kërkuese ka marrë dijeni madje i ka bërë me dije Komisionerit edhe masat e marra lidhur me detyrat e përcaktuara në vendim. Prandaj pretendimi se administratorët nuk dinë gjuhë shqipe, apo nuk kanë qenë të pranishëm në Shqipëri, janë shkaqe jo të arsyeshme për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit të humbur. As në gjykatën e apelit, pala kërkuese nuk provoi se afati ligjor i padisë ka humbur për shkaqe të arsyeshme.

11. Gjykata Administrative e Apelit nuk gjen shkaqe ligjore për të cënuar vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe për këtë arsye bazuar në nenin 50, shkronja "b" të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, përfundimisht vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50, shkronja "b" e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar

VENDOSI :

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 2908, datë 28.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve, afat që fillon nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit.

Tiranë, më 17.05.2017

GJYQTARE

Bernina KONDI

d.v

GJYQTARE

Altina NASUFI

d.v

GJYQTAR

Kastriot SELITA

d.v

vërtetohet njësia me origjinalin

*Kancelari
Leonard Stenby
Stenby*